

INTERVISTË ME DORUNTINA BASHËN

Prishtinë | Data: 10 nëntor, 2017

Kohëzgjatja: 34 minuta

Të pranishëm:

1. Doruntina Basha (E intervistuar)
2. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Doruntina Basha: Unë jam Doruntina Basha, jam dramaturge, skenariste. Kom lindë në vitin 1981 në Prishtinë, jom rritë në lagjen “Dardania” në Prishtinë edhe një pjesë të madhe të fëminisë e kom kalu edhe në qendër të qytetit, saktësisht te zona tash ku është “Radio Prishtina”, domethanë ajo lagje. Në fakt ku ka qenë “Radio Prishtina”, aty ka jetu gjyshja jeme edhe momentalisht jeton tezja jeme.

Edhe kur ta kujtoj fëmininë teme në Prishtinë, t’u u rritë në Prishtinë, e kom atë kujtimin e ndamë domethanë në këto dy lagje, në “Dardani” edhe në qendër. Arsyeya pse e kujtoj fëmijëninë teme në këto dy lagje dhe në asnji lagje tjetër të Prishtinës është thjesht për shkak se familjen, prindët, motrën i kom pasë në “Dardani”, jom shkollu në shkollën fillore “Dardania”, e cila fillimisht ka qenë “Vladimir Iliç Lenin”, mandej u pat’ shndërru në shkollën fillore “Dardania”.

Ndërsa këtë pjesën sociale, të socializimit, të shoqnisë e kom faktikisht kujtimin kryesor e kom në qendër te mahalla e gjyshes teme. Çka muj me nda diçka që ka qenë ndoshta njo prej kujtimeve ma insistuese me thanë, ma kambëngulëse prej fëminisë teme është shkolla fillore “Dardania”. Kur jom regjistru në atë shkollë, motra jeme veç ka qenë t’u e viju mësimin në atë shkollë, ajo është gjashtë vjet e gjysë ma e madhe se unë. Domethanë, unë kur jom regjistru në klasë të parë, motra jeme ka qenë në klasë të shtatë ose tetë.

Jom regjistru në vitin 1988 edhe kur jom regjistru shkolla e ka pasë një lloj prestigji në qytet, se ka qenë në atë kohë shkolla ma e re në qytet, ka qenë shkolla ma e madhe, shkolla ma moderne. Kështu që, kom shku në shkollë me shumë qejf edhe kom qenë shumë krenare që jom regjistru me një shkollë të tillë që e ka një reputacion të tillë. Përnime ka qenë shkolla e re, ka qenë e madhe, ka qenë përjetim kështu shumë i veçantë, mirëpo ndodhi që shumë shpejt ndryshoi situata politike. Në fakt, nuk ndryshoi realisht, vetëm u përkeqësua, edhe shkolla edhe fizikisht e përjetoi qat’ ndryshim, edhe përnjherë prej një përjetimi shumë pozitiv u shndërru në një lloj, s’po di, në një lloj përjetimi të izolimit me thanë kështu shumë konkretisht.

Çka ka ndodhë është që në vitin 1990 kur u përjashtun shumica domethanë shqiptare prej punëve, kur masat e dhunshme faktikisht edhe i mshelën shkollat për shqiptarët, domethanë në atë periudhë shkolla “Dardania” vazhdoi me mbetë e hapun, domethanë vazhdoi, vazhdunë klasët në gjuhën

shqipe me viju mësimin aty, mirëpo shkolla u nda me një mur n'gjysë, domethanë u ndërtu një mur në mes të shkollës mrenda për me i nda paralelet serbe prej paraleleve shqiptare.

Edhe me siguri domethanë një prej kujtimeve që kurrë s'kanë me u fshi prej kujtesës teme është ky mur edhe dita e parë në shtator në klasë të tretë kur kom shku në shkollë edhe e kom pa këtë mur në mes të shkollës. Ka qenë një përceptim kështu shumë i çuditshëm i një ambienti që isha mësu domethanë dy vjet me shku aty me vrapu, i njihsha, i kisha njoftu mirë ato korridore. Shkolla "Dardania" e ka njëfarë strukture, i ka korridoret kështu pak ma të elaborume, edhe tash përnjihërë domethanë hapësina ku na lëvizshim ish e kufizume, ish e ndame.

Çka ka qenë karakteristike është që shkolla ish nda në gjysë, domethanë realisht e krijojke përshtypjen që është nda proporcionalisht, mirëpo t'u e pasë parasysh që numri i paraleleve në gjuhën serbe ka qenë jashtëzakonisht shumë i vogël në krahasim me këto shqiptare, i bika që pjesa ma e madhe e shkollës i takojke nxanësve serbë. Në atë anë normal ish edhe salla e edukatës fizike, domethanë na nuk kishim qasje në sallën e edukatës fizike.

Ndërsa për shkak se numri i nxanësve shqiptarë ish shumë i madh, në këtë pjesën tonë u desht me u improvizu shumë korridore me materiale të ndryshme rrethanore, m'u nda, m'u organizu në klasa ma të vogla. Edhe klasa jeme domethanë prej klasës së tretë ka qenë një klasë e tillë e improvizume në korridor, e ka pasë mure prej shpor- pllakës, ka pasë banka, domethanë na kemi qenë rreth 34-35 nxanës, tash nuk e di saktë, mirëpo ka qenë shumë ngusht mrena se bankat kanë qenë shumë të ngjeshuna njana me tjetrën, edhe në përgjithësi e ka pasë një ndjenjë klaustrofobike kështu për shkak se thjesht nuk i ka pasë ato standardet ose s'ka qenë domethanë klasa qysh u patëm mësu me pasë klasën na.

Sa i përket atmosferës që u pat' kriju edhe qasaj atmosfere që e mbaj në mend, domethanë me këto ndryshime fizike edhe të organizimit në shkollë ka qenë që përnjihërë domethanë shkolla e cila vazhdon me pasë një emër jashtëzakonisht shumë të madh, shkollë e madhe, ka pasë hymje në disa anë të ndryshme edhe përnjihërë domethanë edhe oborri u bo i paqasshëm edhe pse nuk kish ndamje fizike në oborr po thjesht u caktu si një lloj kufini i padukshëm që ti si nxanës shqiptar nuk guxojshe me shkelë ma andej, ish si, u bo thjesht qajo ndamja.

Në përgjithësi u kriju një atmosferë shumë e pakandshme edhe u kriju një atmosferë e tutës. Na realisht nuk u tutshim prej nxanësave tjerë serbë, ndoshta edhe ka pasë konflikte fizike po nuk i mbaj në mend, fundja kom qenë fëmijë. Nuk e besoj që në atë moshë që kom qenë unë ka pasë edhe konflikte fizike, po sigurisht ka pasë me moshë ma të mëdhaja, mirëpo u kriju një ndjenjë e tutës. Krejt kjo domethanë, krejt kjo domethanë u reflektu edhe në shumë aspekte të tjera. U reflektu në ato se qysh përnjihërë u desht m'u nda në ma shumë ndërrime, m'u organizu në ma shumë ndërrime mësimi ynë edhe domethanë u bo kështu u kompliku jeta përnjihërë shumë. Edhe, po, qiky është ai kujtimi që kisha me thanë që është noshta ma i randësishëm i fëminisë.

Aurela Kadriu: A na tregon pak qysh ka ndiku, ndoshta pak një prapavijë të familjes në të cilën je rritë edhe mandej kadal-kadale me na tregu qysh ka ndiku qikjo farë ndamje që o' bo në shkolla, e cila ka ndodhë edhe në aspekte të tjera, qysh ka ndiku në familjen e ju?

Doruntina Basha: Realisht kjo ndamje kur ndodhi në shkollë ish veç një reflektim i ndamjes që ndodhi në shoqni. Shoqnia realisht e ka pasë ndamjen, mirëpo në vitin 1990 ndamja ka qenë qaq e ashpër saqë hala ma shumë e ka thellu ndamjen edhe në shoqni.

Në momentin kur prindët e mi i kanë përjashtu prej punës, domethanë babi ka punu në televizionin e Prishtinës, mami ka punu në “Radio Prishtina”, ata janë përjashtu prej punës në të njëjtën ditë, kështuqë nuk kanë qenë të vetmit normal, janë përjashtu prej punës me të gjithë të tjerët. Mirëpo, a din, ka qenë njëfarë momenti si një lloj pauze e vogël në jetë kur ndalesh me mendu, “Çka me bo tash?”

Edhe kjo ka ndodhë në krejt aspektet, edhe në shkollim, edhe në punën e prindëve, po edhe në aspektin tonë si fëmijë, në aspektin e shoqimit, a din, për shembull në shumë lagje të Prishtinës kanë jetu serbë edhe shqiptarë bashkë edhe... posaçërisht në qendër të qytetit ku unë e kom kalu një pjesë të fëmijës kur shkojsha te gjyshja e te tezja, aty ka pasë fëmijë serbë edhe sigurisht që kemi lujtë bashkë deri në një moment të caktum. Kur ndodhi kjo ndamja, thjesht edhe këto shoqni u ndanë, a din, pa fjalë, pa, a din, pa ndonji marrëveshje, thjesht u krijun kushtet që ish e vetëkuptushme që kjo shoqni nuk mundet me ekzist, nuk mundet me vazhdu.

[Intervista është prerë me kërkesë të së intervistuarës]

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë jeta para se me dalë prindët prej punës, para se me ndodhë kjo ndarje. Edhe mandej qysh ka qenë mbas kësaj, domethanë qajo pika e kthesës, qysh ka ndiku?

Doruntina Basha: Paj jeta ka qenë... për familjen tonë jeta sigurisht ka qenë jetë normale domethanë kur kanë qenë prindët në punë i kanë pasë të ardhurat normale për atë kohë. Kemi shku në pushime, domethanë kemi çu një jetë normale si moshatarët tjerë të mi në qytet. Edhe sigurisht që kur ka ndodhë kjo ndamje, krejt kjo ka ndryshu. Përnjherë domethanë ka pasë edhe çashtje edhe dilema edhe ekzistenciale edhe domethanë, nuk shkojshim mo n’deti, a din, domethanë ka pasë kështu sene të vogla me të cilat na si fëmijë jemi mësu edhe të cilat përnjherë nuk ndodhshin mo.

[Intervista është prerë me kërkesë të së intervistuarës]

Aurela Kadriu: Në shkollë, çka iu thojshin në shkollë, për juve, me siguri ju keni qenë kuriozë. Pse o’nda? Çka thojshin mësuesit?

Doruntina Basha: Këtë pjesë nuk e kom shumë të qartë, e di që përnjherë diskursi ka ndërru. Normal, unë i takoj asaj gjenerate që ka mbërri me u bo pionier edhe kom mbërri qato dy vitet e para të shkollimit me i kry në Jugosllavi, edhe kemi pasë edhe landën serbo-kroate në shkolla edhe do të thotë ka qenë, e kom shiju pak atë Jugosllavinë prej perspektivës së një nxanësit, pionierit.

Masi u ndërta ky muri, sigurisht nuk ishim mo pjesë e qatij tregimi të përbashkët, edhe ka ndryshu diskursi. Unë nuk e kom shumë të qartë edhe nuk kom mundësi me tregu qysh ka ndodhë ky ndryshim, a ka qenë gradual a ka qenë i përnjihershëm për shkak se qaq shumë sene kanë ndodhë, qaq shumë ndryshime ka pasë saqë na si fëmijë e kemi gjetë veten para një suate që duhet me pranu ndryshimin, duhet me i pranu rrethanat e reja. Me kalimin e kohës, duke u rritë ai diskurs u bo edhe pjesë e jona, domethanë fillum edhe na me përdorë që, “Na jemi shqiptarë, nuk takojmë me ata, jemi

të shtypun”, e të tjera, e të tjera. Edhe sigurisht fillum me kuptu situatën ma ndryshe edhe me u bo pjesë e qatij diskursi.

Aurela Kadriu: A e mban në mend prindët çka iu thojshin në shpi?

Doruntina Basha: Prindët e mi, po, në fakt prindët e mi kanë qenë edhe vazhdojnë me qenë të kujdesshëm edhe korrekt, domethanë ata asnjherë nuk kanë dashtë me polarizu asnji situatë kështu në jetë. Kështu që, ajo çka ka ndryshu në familje ka qenë përnjiherë kërkesa edhe presioni i prindëve me pasë shumë kujdes për shkak se në atë kohë ndodhën edhe helmimet e nxanësve edhe e marr me mend që prindët kanë qenë t’u e jetu një frikë shumë t’madhe për shkak se të dy fëmijët i kanë pasë në shkollë në atë kohë edhe shkollimi vazhdojke, domethanë nuk ka pasë ndërpreme. Nuk ka qenë që, “Tash jemi në rrethana të jashtëzakonshme edhe duhet me u ndërpre shkolla”, jo, shkollimi vazhdojke edhe ish pjesë e krejt asaj rezistencës që e bojshim na si shqiptarë në Kosovë.

E mbaj në mend që, një këshillë që nuk muj me harru kurrë është që na pat’ thanë dikush prej prindëve të shoqeve të klasës, “Kur shkoni në shkollë, nëse e ndini një erë si të karanfilit, dilni meniherë prej klasës”. Edhe kjo ka ndejtë me mu për një kohë shumë të gjatë, edhe ma vonë kur jom rritë pak thjesht e kom kuptu që iu kanë referu helmimeve.

[Intervista është prerë me kërkesë të së intervistuarës]

Aurela Kadriu: Mandej a na tregon qysh ka ndodhë qiky kalimi prej shkollës fillore në të mesmen, edhe çka kujton prej shkollës së mesme?

Doruntina Basha: Shkollën e mesme e kom kry në gjimnazin “Xhevdet Doda” aty domethanë në objektin i cili ka qenë aty ku është sot Katedralja “Nëna Terezë”. Arsyeja pse e kom zgjedhë gjimnazin “Xhevdet Doda” është se në atë kohë “Xhevdet Doda” nën një e ka pasë reputacionin si gjimnazi ma i mirë në Prishtinë bashkë me “Sami Frashërin”, por në anën tjetër ka qenë një prej shkollave të pakta të cilat vazhdojshin me vijë mësimin në objektin e shkollës, për shkak se ka qenë koha kur shumica e shkollave ishin zhvendosë në shpija private. Edhe ka qenë në qendër, ka qenë afër shpisë edhe thjesht ka qenë shumë e përshtatshme m’u shkollu, me shku në shkollë aty.

Gjimnazi është një periudhë tjetër për shkak se është mosha tjetër, jonë angazhimet e interesimet e tjera. Pak para se me kalu në gjimnaz domethanë prej shkollës fillore, unë u pata bo pjesë e “Postpesimistëve” për shkak se në atë kohë ka ekzistë një lloj thirrje që m’u angazhu disa njerëz të ri, m’u bo pjesë. Kështu që, unë kur kom qenë në gjimnaz, kur jom regjistru në vitin e parë në gjimnaz unë veç kom qenë pjesë e “Post-pesimistëve” bashkë me shumë prej shoqeve edhe shokëve të cilët kemi vazhdu prej shkollës fillore me studiu në gjimnazin e njëjtë.

Kështu që, gjimnazin e kom kalu me shumë aktivitete në fakt edhe ka qenë një periudhë kur domethanë e kemi përceptu, edhe unë edhe shoqnia jeme në atë kohë, e kemi përceptu rolin tonë jo vetëm si nxanës po diçka pak ma të randësishëm në shoqni, domethanë si lloj aktivista me thanë njëfarë mënyre. Edhe gjimnazi e ka një lloj tregimi domethanë të ndamjes, e ka njëfarë muri edhe gjimnazi në mes, edhe pse nuk ka qenë fizik. Gjatë shkollimit në gjimnaz, në vitin 1999 kur unë kom qenë në vit të tretë, kanë ndodhë bombardimet edhe u dashtë me ndërpre gjimnazin domethanë,

edhe pas bombardimeve kur jemi kthyer domethanë në shkollë, i kemi përfunduar dy vite përnjihërë, vitin e tretë edhe vitin e katërt në mënyrë që me mujtë me përmbyllë vitin shkollor.

Kjo ka qenë një përjetim shumë i çuditshëm për shkak se përnjihërë shkolla e cila deri në atë kohë ka qenë një lloj rezistence, e kemi pasë njëfarë kambëngulësie që, pavarësisht rrethanave çka ndodhte, na shkollohemi, përnjihërë u shndërru në diçka që duhet me u kry brenda natës për me kry një lloj obligimi edhe me dalë në një etapë të re, edhe kjo ka ndodhë.

Aurela Kadriu: A rrijmë edhe pak te shkolla e mesme...

Doruntina Basha: Diku rreth vitit 1996, një shoqe e shkollës më pat' telefonu nëse e mbaj në mend saktë edhe thjesht më pat' pytë, "A po don me u bo pjesë e 'Post-pesimistave'?" Edhe normal në atë kohë nuk ka pasë shumë aktivitete që ndodhshin në Kosovë edhe me qenë për neve tinxherave, "Uau!"

"Post-pesimistat" kanë qenë të vetmit të cilët organizojshin ndeja, ekspozita, kanë pasë revistën që... në fakt gazetën e cila u botojke me "Kohën Javore" një kohë, edhe unë e kisha pa edhe krejt e kishin pa edhe ish qysh me thanë... ish ajo dritarja e vogël e vetme që a din, mujshe me kqyrë jashtë edhe me të interesu çka po ndodhë andej. Edhe kështu që, kur më telefonoi kjo shoqja edhe ma boni këtë ftesë, isha kështu totalisht e impresionime, edhe menjihërë thashë, "Po!" Edhe kemi qenë një grup edhe i shoqnisë domethanë, persona me të cilët domethanë veç i njihsha edhe i kom pasë në shkollë, të cilët u bonëm pjesë e "Post-pesimistave".

E kemi pasë takimin e parë në zyrën e "Post-pesimistave" në rrugën e cila sot është "Rexhep Luci", aty e kanë pasë zyrën fillimisht. Jemi mledhë aty, kemi qenë një grup ndoshta prej 15-20 të rive. Na ishim gjenerata e re domethanë e "Post-pesimistëve" edhe menjihërë kemi fillu me aktivitete të ndryshme, janë organizu shumë ndeja, janë organizu ekspozita. U publikojke domethanë gazeta, u publikojke edhe revista "Hapi Alternativ" e cila mas një kohe u ndërpre edhe thjesht u angazhum. Secili u angazhu me diçka. Unë u angazhova edhe me gazetë edhe me revistë, edhe shkrujsha shkrime të cilat u botojshin. Mas një kohe isha edhe redaktore për një kohë të shkurtë, e gazetës. Gazeta dikur nisi me dalë domethanë edhe vetë, mujshe me pa nëpër shtande, nëpër trafika gazetën. Kemi qenë shumë krenarë me atë që e bojshim, normal.

Ka qenë njëfarë tendence me normalizu jetën e rinisë në Kosovë në atë kohë, pos asaj ka qenë diçka hala ma shumë, për shkak se "Post-pesimistat" kanë qenë pjesë e një rrjeti rajonal, edhe për shumë prej neve ka qenë mundësia e parë edhe hera e parë që na me taku moshatarët tonë jashtë Kosovës, edhe kjo ka qenë jashtëzakonisht e randësishme për atë kohë për shkak se kemi jetu në rrethana ku ka qenë e pamundun, pothuajse e pamundun me taku dikon tjetër që jeton jashtë kufinit të Kosovës.

Kështuqë, "Post-pesimistat" kanë pasë ndikim jashtëzakonisht shumë të madh qysh jemi formu na si rini në atë kohë, na që kemi qenë pjesë e tyre, po mendoj edhe në përgjithësi rinia të cilët kanë marrë pjesë në aktivitete të "Post-pesimistave" ose në një ose tjetër mënyrë është asociu me "Post-pesimistat".

Ka qenë në njëfarë mënyre si një lloj thymje e disa kufijve që i kemi pasë ndoshta edhe të brendshëm, po edhe kufijve realisht që i kemi pasë edhe kështu si shoqni. Me “Post-pesimista” për herë të parë kom udhëtu kështu në kampe të të rive edhe kom taku njerëz tjerë prej rajonit edhe përdërisa kom mësu shumë gjatë këtyne udhëtimeve për rajonin, për rininë e rajonit, për problemet me të cilat ballafaqohen ata, në anën tjetër ka qenë shumë interesant me e marrë vesh edhe me e mësu që në fakt ka paragjykime, për shkak se ka qenë hera e parë që e kom kuptu që për shqiptarët e Kosovës ka shumë paragjykime jashtë Kosovës a din, për herë të parë e kom kuptu që kur dalim na jashtë Kosovës, njerëzit na shikojnë ndryshe për shkak se hala pa na njoftu e kemi na një reputacion, e kemi një emër specifik, ka qenë shokuese në të njëjtën kohë.

Po kjo e ka forcë ndoshta ma shumë atë nevojën, atë dëshirën për me qenë pjesë e “Post-pesimistave” edhe për me qenë pjesë e kësaj lëvizje kisha me thanë. Ka pasë aktivitete të lloj-llojshme, të ndryshme të cilat kanë vazhdu. Ajo ka qenë si një lloj cikli që nuk u ndalke, vishin njerëzit e ri e kryjshin një lloj misioni edhe dilshin, mandej vishin njerëz tjerë. Kështu që, me “Post-pesimista” kom qenë e angazhume ndoshta deri një kohë pak mas luftës, ndoshta ’99, 2000 edhe mandej veç u pat’ ndërru krejtësisht domethanë përmbajtja edhe struktura brenda edhe kanë ardhë njerëz të ri edhe kanë vazhdu deri disa vite mbas asaj.

Aurela Kadriu: A na tregon për qato, i përmende ndejat, ekspozitat, në përgjithësi ndaj kujtim që spikatë në kujtesën tande rreth organizimit të aktiviteteve, rreth punës që u bojke në grup, muhabeteve që u bojshin kur organizojshit diçka?

Doruntina Basha: Kujtimet kryesore me “Postpesimista” i kom në zyrën që e përmenda ma herët, domethanë që ka qenë aty ku është sot “Strip Depo” më duket në rrugën “Rexhep Luci”. Edhe, nuk ka qenë angazhim standard në kuptimin e asaj që ke shku në një orar të caktum, aty ki shku kur ki dashtë njëfarë mënyre edhe gjithmonë ka pasë diçka që ndodhke aty mrena, gjithmonë ka pasë njerëz. Ka qenë interesant se ka qenë një atmosferë shumë e relaksime edhe prej fillimit jemi akomodu shumë shpejt.

Gjithmonë ka pasë njerëz edhe takojshë shumë njerëz të ri që s’i ke pa ma herët domethanë prej fushave të ndryshme po në njonën ose tjetrën mënyrë u dufke me bashkëpunu me ata për shkak se na lidhke qajo puna. Nuk ka pasë hierarki, nuk e mbaj në mend që ka pasë organizim të tillë aty, për shkak se secili e kemi pasë ka një rol edhe secili e kemi kry atë rol. Thjesht, më duket që nuk ka pasë nevojë me pasë rregullim me hierarki edhe me i raportu dikujt çka je t’u bo, qaq kemi qenë të investum krejt për me bo diçka për me e ngjallë jetën e të rive në Prishtinë, saqë krejt shkojshim aty me energjinë ma të madhe edhe e bojshim krejt ato çka dishim ma s’miri me bo.

Mbaj n’mend ndoshta çka ashtu ma s’shumti e kujtoj, kanë qenë orët e vona të dizajnit edhe të thymjes, faqosjes së gazetave e të redaktimit të shkrimeve. Nuk kanë qenë ngarkesa a din, nuk asocioj stres me atë kohë, në asnjë mënyrë, ka qenë jashtëzakonisht argëtuese me i bo krejt ato gjana, thjesht njëfarë lloj imitimi i të rritunve. Se njëfarë lloj, nuk e di, njëfarë, me pasë qasje në një punë serioze të cilën e imagjinon që qashtu duhet me u bo, po je fëmijë, je i ri, a din, edhe normalisht që me sinqeritetin ma të madh edhe me pasionin ma të madh i qasësh.

Kështu që, “Postpesimistat”...Kur thom sot “Postpesimistat”, më kujtohet ajo zyre, më kujtohet ajo salla, dhoma e madhe që e ka pasë një lloj tavoline ovale, një kuzhinë e vogël ku pishim çaj edhe dhoma tjetër ku ishin kompjuterat ku u bojke faqosja. Maj mend që për shumë aktivitete u organizojshim shpesh edhe dilshim me i ngjitë posterat, ajo ka qenë diçka, a din, tash kur e thom është... nuk është kurgjo e jashtëzakonshme po në atë kohë, a din, kur u organizojshim me dalë me ngjitë postera ka qenë pothuajse me bo diçka ilegale, a din, e kishim qasi emocioni që, “Uau! Po dalim me ngjitë postera në 6 të mëngjesit nëpër qytet”. Gjithmonë, a din, ka qenë shkas për m’u taku edhe me kalu kohë bashkë.

Aurela Kadriu: Aktivitetet, ndejat, ku i organizojshim, edhe a mban diçka në mend prej tyne, çfarë temash kanë pasë kryesisht?

Doruntina Basha: Kemi pasë aktivitete që janë mbajtur edhe në zyre, ekspozita. Ka pasë aktivitete, ndeja që janë mbajtur edhe nëpër lokale në atë kohë, për shembull te “Santea”, edhe në vende të tjera. Ka pasë... në vende të ndryshme realisht. Tash, a din, në Prishtinë në atë kohë ka pasë... numri i vendeve ku janë organizu aktivitetet ka qenë i kufizim, ka qenë i njëjti domethanë, qato vendet e njëjta i shfrytëzojshim edhe na. Kemi mbajtur ndeja, ma vonë kur e kemi ndërru lokacionin, kemi mbajtur ndeja, e kemi pasë një shpi ma vonë.

Ma vonë domethanë e kemi pasë një shpi me qira në lagjen “Tophane”, shumë afër rrugës “UÇK” që është sot edhe ajo ka qenë shpi e madhe, ka ofru mundësi domethanë që shumë prej aktiviteteve, ekspozitave me u mbajtur aty. Këto janë aktivitete ma vonë që i kemi organizu. Ka pasë koncert, muzikë të gjallë mrena, aktivitete me... artistike, ekspozita me instalacione, me piktura e të tjera, me fotografi. Po edhe *workshope* [punëtori] edhe aktivitetet tjera, krejt i kemi mbajtur aty mrena, domethanë për shkak se kemi pasë mundësinë, e kemi pasë hapësinën shumë ma të përshtatshme.

Dikur në një moment të caktim ma vonë domethanë diku kah...pak kah fundi i të ’90-tave u pat’ kriju edhe grupi... brenda “Post-pesimistëve” grupi i anëtarëve serbë të Prishtinës me atë idenë domethanë të normalizimit të marrëdhënieve mrena rinisë shqiptaro-serbe, mirëpo kjo ka ndodhur shumë afër para shpërthimit të luftës edhe nuk ka pasë shumë aktivitete të përbashkëta që janë mbajtur. Kështu që, kur filloi lufta, zyra u braktis normal, edhe mandej është plaçkitë e të tjera, e të tjera. Edhe thjesht nuk iu dha mundësi kësaj ideje që domethanë me pasë serbë edhe shqiptarë në “Post-pesimista” në Kosovë m’u zhvillu ose me pa kah po shkon.

Aurela Kadriu: E përmene që keni udhëtu nëpër kampe të fëmijëve, a na tregon qysh ka qenë për juve përvoja e udhëtimit deri në vendin ku e keni mbajtur...

Doruntina Basha: Udhëtimin e parë që e kom bo me “Post-pesimistat” ka qenë në Mostar në Bosnjë e Hercegovinë edhe ka qenë menjherë mas luftës në Bosnje, domethanë ka qenë diku viti ’96. ’97, edhe ka qenë fluturimi jem i parë me aeroplan, kështu që kom pasë shumë arsye me iu gëzu këtij fluturimi, nën një që po shkoj me një kamp ku ka me pasë shumë moshatarë të mi prej krejt rajonit, po në anën tjetër që kom me fluturu me aeroplan për herë të parë.

E di që kemi udhëtu me autobus deri në Beograd edhe në Beograd e kemi marrë aeroplanin për Sarajevë, mandej prej Sarajevës kemi udhëtu në Mostar. Ka qenë verë, ka qenë jashtëzakonisht shumë

nxehtë edhe kemi qenë në një pushimore të fëmijëve atje, në një lloj hapësine shumë të madhe ku ka pasë gjenerata të ndryshme të “Post-pesimistëve” prej krejt rajonit. Ka pasë domethanë diskutime, takime, kemi pasë aktivitete tjera, *workshopa*, po në përgjithësi ideja ka qenë që na me u taku, me u njoftu mes veti edhe thjesht m’u njoftu kush jemi.

Aty ka ndodhë një sen shumë interesant, ato që e thashë ma herët që ka qenë takimi jem i parë me idenë e paragjyqimeve mes njerëzve. Aty u taku një lloj befasi, një performancë kështu befasi që e organizun vetëm disa anëtarë, domethanë shqiptarë, boshnjakë edhe serbë, të cilët e improvizun një përklamje në mes të një takimi shumë serioz që e patëm. Ata e organizun një përklamje me shumë gjuhë fyese edhe ofenduese ndaj njoni-tjetrit të bazun në qato stereotipe, mënyra qysh e përceptojshim na njoni-tjetrin.

Edhe e mbaj në mend që kom qenë shumë e shokume edhe e kom marrë atë fascikllën që e kemi pasë që na i kanë dhanë krejt materialet, kom dashtë me u çu me shku prej atyhit se kom thanë, “Krejt është kjo rrenë!” (qeshë) Po shumë shpejt... edhe krejt kemi qenë të shokum se kërkush s’e ka pritë për shkak se performanca ka qenë qaq mirë e lujtun edhe qaq shumë ka pasë urrejtje, a din, sa që thjesht kërkush nuk dojke me ndejtë mo aty në qat’ dhomë.

Mirëpo, ata shumë shpejt u kthyn na tregun që kjo është veç performancë, a din, veç me tregu deri ku shkon paragjykimi edhe qajo urrejtja ndërnjerëzore. Edhe sigurisht mandej na lindi ideja që me organizu një lloj performance të tillë publike në qytet, edhe e patëm organizu, bile ka pasë edhe televizione të cilët e patën xhiru, edhe thjesht ka qenë si mesazh prej rinisë së rajonit domethanë...

Aurela Kadriu: Në Mostar atje e keni bo, a po?

Doruntina Basha:...po. Edhe ka qenë, ka qenë, nuk e di, e kujtoj kto, kështu e kom posaçërisht atë momentin kur ia nisa me i kqyrë njerëzit përreth me pa, a din, qysh po reagojnë, edhe e pushë që krejt ishin shumë të irritum edhe dojshin thjesht m’u largu prej atyhit, e kom kështu si kujtesë shumë të kthjellët. Ka qenë moment shumë i randësishëm. “Post-pesimsitat” e kanë bo qato, domethanë, në qat’ periudhë kanë diskutu edhe për paragjykimet edhe... mes popujve në Ballkan.

Aurela Kadriu: Qysh ka ndodhë shkëputja prej “Post-pesimistëve”, a ka pasë diçka definitive?

Doruntina Basha: Jo, realisht shkëputja prej “Post-pesimistëve” ka ndodhë shumë natyrshëm edhe ka qenë si pasojë e thjesht interesimit në gjana tjera, orientimit në gjana tjera. Ka qenë periudha kur kom fillu me përfundu shkollën e mesme, m’u orientu kah fakulteti edhe thjesht nuk e di, i erdh fundi atij kapitulli të jetës.

[Intervista është prerë me kërkesë të së intervistuarës]

Aurela Kadriu: Mandej, çka keni bo, po mendoj qysh, me studime ose qysh ka vazhdu jeta juj mbas kësaj periudhës së kthimit tash?

Doruntina Basha: Unë i takoj një gjenerate e cila ka pësu shumë ndamje të thella, domethanë edhe gjatë shkollimit po edhe krejt këto zhvillimet çka kanë ndodhë politike në Kosovë edhe shoqnore, janë reflektu shumë thellë në gjeneratën teme në atë se me çka janë identifiku, çka kanë andërru edhe çka

kanë bo për me e realizu ato. Për shembull, zgjedhja e... zgjedhjet n'jetë të cilat i kemi bo, janë ndiku shumë prej qityne rrethanave dhe shumë shpesh zgjedhjet që i kemi bo kanë qenë ose të përfaqëta me ato që kemi dashtë përnime me bo ose thjesht kanë qenë zgjedhje krejtësisht tjera për shkak se kushtet në të cilat jemi rritë kanë qenë shumë të vështira për me mujtë me realizu veten edhe për me mujtë, nuk e di, me realizu atë andrrën që kemi pasë qef gjithmonë.

Nuk e di, një numër i madh në gjeneratën teme, nuk e di a kanë mbri me u bo ata njerëz që kanë pasë qef me u bo kur të rriten, a din. Unë për veti kom zgjedhë me studiu dramaturgjinë në Fakultetin e Arteve edhe në atë kohë kom qenë e bindun që është ideja ma e mrekullueshme në botë. Me dramën jom njoftu kur kom qenë në shkollë të mesme, i kemi pasë disa antologji të dramës avant-garde në shpi edhe i lexojsha edhe nuk e di, shumë kështu më pat fascinua mundësia që drama e krijojke me lujtë me zhanre, me fjalë.

Edhe mandej e regjistruva dramaturgjinë në Prishtinë, pavarësisht që ish viti 2000, pasojat e një sistemi arsimor domethanë i cili ka qenë gjatë të '90-tave ishin shumë prezente hala domethanë, kish shumë gjana jofunksionale, kish shumë improvizim, edhe thjesht kish mungesë të strukturës e cila na mungojke neve studentave shumë. Edhe muj me thanë që prej perspektivës teme, prej perspektivës tonë, domethanë gjeneratës teme, me studiu në Kosovën e lirë ka qenë pak a shumë njëjtë si me studiu në Kosovën para çlirimit për shkak se nuk e di, me siguri vetë sistemi i arsimit ka qenë i lodhun edhe ka qenë i traumatizim prej krejt ndryshimeve.

Kom diplomu në vitin 2004 edhe mandej në vitin 2006 vendosa me bo diçka tjetër edhe regjistruva një master në humanistikë, një program të Erasmus Mundus edhe shkova në Skotlandë, Itali edhe Francë edhe e përfundova masterin.

Aurela Kadriu: Edhe mandej kur jeni kthy, a jeni kthy menjherë a po?

Doruntina Basha: Po, menjherë mas masterit jom kthy në Prishtinë, e bindun që tash jom përgatitë, jom pajisë mirë në jetë. Edhe ka qenë një periudhë shumë e vështirë për me gjetë punë, ma në fund e gjeta një punë mas nja dy-tre vjetve edhe nuk e di, gjanat ndryshojshin domethanë, ndryshimi ndodhke gjatë krejt kohës po e kom përshtypjen me një ritëm shumë ma të kadalshëm se sa që na kishim nevojë, edhe realisht po vazhdon me ndodhë qashtu.

Nuk e di pse e kom pasë përshtypjen që nëse unë e boj një master jashtë vendit, jeta jeme automatikisht ka me u përmirësu në Kosovë edhe për atë arsye edhe jom kthy. Mirëpo, nuk ka qenë qashtu, edhe për shumë njerëz vazhdon mos me qenë qashtu edhe sot fatkeqësisht.